



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E PATOS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE INFORMIMIT PUBLIK

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**SPECIALIST I INTEGRIMIT EUROPIAN, KOORDINIMIT TË FONDEVE TË HUAJA
DHE RINISË**

Ne zbatim te nenit 22 dhe 25 te ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V, të Vendimit nr. 243, date 18.03.2015 te Keshillit te Ministrave "Per pranimin, levizjen paralele, peridhen e proves dhe emerimin ne kategorine ekzekutive", Bashkia Patos shpall procedurat e levizjes paralele dhe e pranimin në shërbimin civil për pozicionin:

1 vend pune si Specialist i Integrimit European dhe Informimit Publik në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria e pagës IV-a.

Pozicioni i më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e levizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së levizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimin në Shërbimin Civil

Për të dy Procedurat (levizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

29/06/2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

02/07/2026

• **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist i Integritetit Evropian:**

1. Bashkërendon dhe mbështet strukturat administrative të Bashkisë për zbatimin e politikave, të legjislacionit, të investimeve dhe të shërbimeve të lidhura apo që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, në nivel vendor;
2. Bashkërendon me strukturave administrative dhe përfaqësimi i Bashkisë në marrëdhënien me strukturat e qeverisjes qendrore, përgjegjëse për integrimin evropian dhe proceset përbërëse të tij;
3. Bashkërendon me strukturat administrative të Bashkisë për rritjen e kapacitetit përthithës të përdorimit të asistencës së Bashkimit Evropian për procesin e integritetit evropian në nivel vendor;
4. Bashkërendon, organizon dhe drejton i aktivitetit publik të Bashkisë, me qëllim realizimin e funksioneve të veta apo të deleguara në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe të zbatimit të asistencës të Bashkimit Evropian për këtë proces;
5. Mbështet strukturat administrative të Bashkisë për përgatitjen, zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe informimin për projektet e financuara nga programet e asistencës së Bashkimit Evropian për procesin e integritetit evropian në nivel vendor;
6. Harton çdo 6 (gjashtë) muaj ose, nëse kërkohet, sipas rastit, për të informuar Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, lidhur me përmbushjen e kritereve dhe të standardeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian dhe/ose zbatimit të asistencës së BE-së, për funksionet e veta apo të deleguara të Bashkisë;
7. Informon në mënyrë periodike i publikut dhe i grupeve të tjera të interesit për procesin e integritetit evropian, për politikat e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian, nëpërmjet këndeve të Bashkimit Evropian, të cilat krijohen dhe funksionojnë brenda Bashkisë;
8. Administron dhe publikon informacionin rreth Bashkimit Evropian dhe procesit të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë, informacion i cili duhet të ketë formë dhe përmbajtje të unifikuar për të gjitha bashkitë;
9. Organizon i aktivitetet informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Evropian, me mbikëqyrjen dhe mbështetjen e strukturave të Koordinatorit Kombëtar të Instrumentit të Parazgjerimit (NIPAC).
10. Siguron që i gjithë informacioni lidhur me zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian, përfshirë raportet e progresit, raportet finale, produktet e levruara si studime, publikime, si dhe raportet financiare sebashku me kopje të faturave) është i depozituar fizikisht (me dosje) dhe në mënyrë elektronike në sistemin e arkivave të bashkisë.
11. Siguron ngritjen e Bazës së të Dhënave për projektet që zbatohen nga bashkia, të financuara nga programet e BE-së dhe donatorët e tjerë. Përditësimin periodik të saj me të dhënat financiare (shpenzimet/disbursimet) dhe rezultatet e arritura në zbatimin e projekteve, përmes përcaktimit dhe matjes së indikatorëve/treguesve të nivelit të lartë;
12. Krijon, në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, të një Sistemi Informacioni ku të evidentohen të gjitha projektet me financim të huaj që realizohen në territorin e bashkisë (projektet që zbatohen direkt nga bashkia, ato që zbatohen nga institucionet qendrore dhe organizatat e shoqërisë civile). Prioritet të veçantë do të kenë projektet e financuara nga Bashkimi Evropian;
13. Dërgon raportin e progresit në vëmendje të Kryetarit të Bashkisë dhe strukturave të tjera vendim-marrëse të Bashkisë. Kopje e raportit i dërgohet Ministrisë së Brendshme/Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e lëvizjes paralele janë:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Te zoteroj diplomë “Bachelor”, Master Profesional ose Shkencor në Shkenca Sociale. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune mbi 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgojë dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, këto dokumenta:

- a. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- b. Një kopje të jetëshkrimit.
- c. Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- d. Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- e. Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- f. Fotokopje të një vleresimi vjetor.
- g. Fotokopje të aktit të konfirmimit të Statusit të nëpunësit civil.
- h. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- i. Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- j. Fotokopje e letërnjoftimit.
- k. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- l. Vërtetim gjëndjes shëndetsore;

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 29.06.2026.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **30.06.2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkisë Patos do të shpall në portalin Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- b. Njohuritë mbi ligjin nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c. Njohuritë mbi ligjin nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- d. Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”
- e. Njohuritë mbi ligjin nr.9 590, datë 27.7.2006, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”.
- f. Njohuritë mbi Kartën Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore
- g. Njohuritë mbi VKM-në nr. 450 datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore”.

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet me 60 pikë.

Totali i pikëve është 100 pikë.

1.6

DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Për datën dhe vendin e konkurimit kandidatët do të njoftohen nga Drejtoria e Burimeve Njerezore. Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Patos do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Patos dhe në portalin e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në Shërbimin Civil

Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ky pozicion do të jetë i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë personat që janë jashtë shërbimit civil.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil:

- a. Te jete shtetas shqiptar;
- b. Te kete zotesi te plote per te vepruar;
- c. Te zoteroje gjuhen shqipe, te shkruar dhe te folur;
- d. Te jete ne kushte shendetesore qe e lejojne te kryeje detyren perkatese;
- e. Te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundervajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij te mos jete marre masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil, qe nuk eshte shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Te zoteroj Diplomë “Bachelor”, Master Profesional ose Shkencor në Shkenca Sociale. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim;
- b- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (përfshirë diplomën bachelor, master professional ose shkencor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësime pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucionin e Bashkisë Patos, brenda datës 02.07.2026.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **03.07.2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos do të shpallë në portalin e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkak të moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individua, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e depozitimit të ankesës.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- b. Njohuritë mbi ligjin nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c. Njohuritë mbi ligjin nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- d. Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”
- e. Njohuritë mbi ligjin nr.9 590, datë 27.7.2006, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”.
- f. Njohuritë mbi Kartën Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore
- g. Njohuritë mbi VKM-në nr. 450 datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore”.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimi, i ngritur pranë Bashkisë Patos.

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pike të cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

2.6 DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Patos, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimi në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Patos duke filluar nga data 15/07/2026.

DREJTORE
Irisi Xhelaj